



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetaska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

DATË/A:	19.07.2021
PËR/ZA/TO:	Z. Vlora Spanca, Auditor i Përgjithshëm, Republika e Kosovës
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Dr. Aida Rexhepi, Kryesuese e BD të SHSKUK-së Dr. Valbon Krasniqi, Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së
NGA/OD/FROM:	Enver Gashi, Drejtor Financiar i SHSKUK-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Veprimit për Zbatim të Rekomandimeve nga Raporti i Auditimit për PVF 2021 i kryer nga Auditoret e Zyrës Kombëtare të Auditimit – ZKA

E nderuar znj. Auditore e Përgjithshëm

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion unik, i themeluar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përderisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është miratuar në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendim nr. 05/148, datë 11.09.2013. Themelimi i SHSKUK-së është e saktësuar në nenin 60 të Ligjit për Shëndetësi në paragrafin e parë të këtij neni, theksohet se Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës themelohet si institucion autonom dhe i pavarur publik shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës është funksionalizuar në Qershor të vitit 2014 pas kryerjes së procedurave për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit Financiar të SHSKUK-ës .

Në bazë të raportimeve nga Programet dhe Nënprogramet Buxhetore të SHSKUK është konstatuar se Rekomandimet e Auditimit të PVF-ve për vitin 2021 janë në zbatim e sipër dhe zbatimi i të gjitha rekomandimeve pritet që të arrihet deri në fund të vitit 2022.

Ju njoftojmë se raporti i planit të veprimit për zbatim të rekomandimeve të cilin jemi duke i'u dorëzuar është përpiluar duke u bazuar në raportet e dërguara nga Programet dhe Nënprogramet Buxhetore që janë në vartësi të Organizatës Buxhetore të SHSKUK-së, si dhe në raportin e grupit të punës të Planit të Veprimit për Zbatim të Rekomandimeve nga Raporti i Auditimit për PVF të vitit 2021 të paraqitura nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit –ZKA.

Zbatimi i Rekomandimeve të Raportit të Auditimit për vitin 2021 si dhe të Auditimeve nga vitet e mëprashme janë prioritet i Bordit Drejtues të SHSKUK si Organ me i lartë Vendimarrës dhe Stafit të Menagjmentit të lartë të Ekzekutivit të SHSKUK-së.

Nr .	Komponenta e auditivit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndermarrë	Zyrtari/et përgjegjes	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komentet
1	2	3	4	5		6	7
	Opinionit i auditimit	Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.					
1	Çështja A1	Çështja A1 - Gabime në përlllogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit Gjetja Sipas nenit 22 të rregullores MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore përcaktohet metoda e zhvlerësimit të pasurive, norma si dhe llogaritja bazuar në natyrën e pasurisë Në 21 raste, nga 140 mostra të pasurive të testuara, kemi vërejtur që këto pasuri ishin kategorizuar gabimisht sa i përket klasave të pasurisë, duke shkaktuar gabime në vlerë 1,219,516€ në përlllogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit (zhvlerësimi i akumuluar). Në 15 mostra shpenzimet e zhvlerësimit ishin nënvlerësuar për vlerën	Rekomandimi A1 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të aplikojnë analiz të mirëfillt të regjistrit të pasurisë për të siguruar se ato janë kategorizuar drejtë në menyrë që saldo e bartur në vitin vijues të ofroj informata të sakta dhe raportim të drejtë në PVF	A1 Për të trajtuar këtë çështje, do të krijohet një grup i veçantë i cili do të ketë përgjegjësinë për hartimin e një plani specifik të veprimit për të adresuar këto të gjetura që kanë të bëjnë me investimet kapitale të realizuara në ShSKUK që prej viteve 2007-2008 e tutje.	BD, DP, ZKF, zyrtari i pasurisë	Tetor	Nga 21 raste, 18 janë nga viti 2015/16 ndërsa 3 raste në 2020

		<p>1,132,056€, ndërsa në gjashtë mostra ishin mbivlerësuar për vlerën 87,460€ duke e mbivlerësuar/nënvlerësuar pasurinë për këtë shumë. Gabimet kishin rezultuar kryesisht nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kategorizimi i pajisjeve mjekësore me jetëgjatësi prej pesë vite si "objekte shëndetësore" dhe "struktura tjera" me jetëgjatësi prej 40 vite, apo "ndërtimi i rrugëve" me jetëgjatësi 20 vite; • pajisje mjekësore dhe objekte ishin regjistruar si investim në vijim, duke mos ju aplikuar zhvlerësimi, ndonëse ishin funksionale dhe në përdorim; • pajisje mjekësore me jetëgjatësi prej pesë vite ishin regjistruar si "pajisje të IT" me jetëgjatësi prej tre vite etj. <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se me rastin e blerjes së këtyre pasurive ndër vite, shpenzimet ishin keq klasifikuar dhe në regjistrin e pasurive ishin regjistruar sipas kodit të shpenzimit, dhe jo sipas natyrës së pasurisë.</p>					
2	Çështja B1	<p>Çështja B1 - Mbivlerësim/nënvlerësim i pasurisë kapitale</p> <p>Gjetja Sipas rregullores MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.3 specifikon se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK". Më tutje, neni 10 i rregullores së njëjtë, parasheh</p>	<p>Rekomandimi B1</p> <p>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrollat e duhura të cilat mundesojnë që blerjet e pasurisë kapitale të regjistrohen në vlerën e sakt,</p>	<p>B1 Konfirmojmë se të gjitha këto të gjetura janë adresuar dhe gjendja e tyre është e rregulluar edhe në SIMFK.</p>	BD, DP, ZKF, zyrtari i pasurisë	I zbatuar	Pasi është verejtur që është bërë gabimi teknik menjëher janë përmirësuar

	<p>që "Të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe i vlerësimit".</p> <p>Pasuria kapitale ishte nënvlerësuar për 837,390€, për shkak se tetë pagesatë vitit 2021 nga investimet kapitale nuk ishin evidentuar në regjistrin e pasurive në SIMFK. Detajet e këtyre pagesave, janë prezantuar në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tetë pagesa në vlerë 822,473€ për dy projektet kapitale: "Ndërtimi i Objektivit për Nënë dhe Fëmijën" dhe "Mbindërtimi - Laboratori i Karakterizimit Prizren", ishin realizuar nga SHSKUK për SP Prizren; dhe • Një pagesë në vlerë 14,917€ për pajisje mjekësore për Ortopedi nga SP Gjakovë. <p>Nga ana tjetër, pasuria kapitale ishte mbivlerësuar për 2,533,543€, si rezultat i gabimeve teknike në regjistrime, për rastet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pajisja mjekësore e blerë në vitin 2021 "Linear accelerator with necessary components-accessories" në vlerë prej 1,487,777 €, ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë me vlerë totale, edhe pse pagesa për të nuk ishte realizuar si e plotë. Pas pagesave të tjera në vlerë prej 620,777€ (SHSKUK - 577,000 dhe QKUK- 43,777€), këto ishin regjistruar edhe njëherë në regjistrin e pasurisë, duke e mbivlerësuar 	<p>në mënyren që të mundesohet regjister I saktet I pasurisë dhe raportim I drejt I PVF</p>				
--	--	---	--	--	--	--

	<p>pasurinë për këtë shumë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Situacioni i parë i përkohshëm në vlerë të pjesshme të paguar 59,937€ për projektin "Zgjerimi i Kapaciteteve të rrjetit të Gazrave Medicinale në klinikat e QKUK-se" ishte regjistruar gabimisht dy herë (ID i pasurisë 77080 dhe 80239). Ngjashëm kishte ndodhure dhe në pagesën e pjesshme në vlerën prej 52,829€ për projektin "Zgjerimi i Kapaciteteve të rrjetit të Gazrave Medicinale në klinikën e Pulmologjisë" (ID e pasurisë 77086 dhe 80235); dhe • Gjatë regjistrimit të situacionit të tretë përfundimtar për kontratën me titull "Zgjerimi i kapacitetit të rrjetit të gazrave medicinale në klinikat e QKUK-se" në shumën 184,821€ ishte bërë gabim teknik gjatë regjistrimit nga Zyrtari i pasurisë, duke e mbivlerësuar vlerën e pasurisë për 1,800,000 €. Pas kryerjes së auditimit, SHSKUK na ka ofruar dëshmi për korrigjimin e këtij gabimi tek regjistri i pasurisë, mirëpo në PFV nuk ishte reflektuar ky korrigjim. <p>Sipas zyrtarit përgjegjës për regjistrim të pasurisë, kjo kishte ndodhur si rezultat i presionit kohor për regjistrimin e numrit të madh të pagesave që ishin bërë në muajin e fundit të vitit. Ky devijim nuk ishte identifikuar dhe parandaluar nga kontrollet e brendshme me rastin e rishikimeve</p>					
--	--	--	--	--	--	--

3	<p>Cështja B2</p>	<p>Cështja B2 - Nënvlërësim i pasurisë nën 1000€ Gjetja Rregullorja MF nr. 02/2013 për menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 18, përcakton se inventarizimi i pasurisë jo financiare, të bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Më tutje, neni 19, pika 4.3 specifikon se duhet të bëhet krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Programet funksionale në kuadër të SHSKUK, kishin kryer inventarizimin e pasurisë jo financiare, mirëpo raportet e inventarizimit nuk ishin harmonizuar/krahasuar me gjendjen faktike të pasurisë. Kjo ka ndikuar në pasaktësinë e informatave rreth gjendjes së pasurive të prezantuara në PFV, si në vijim: • Spitali i Prizrenit në pasqyrat individuale kishte shpalosur pasuri nën 1000€ në vlerë 7,351€ që gjithashtu përfshinte vetëm blerjet e vitit, duke bërë një nënvlerësim të pasurisë përafërsisht 716,837€ (kalkulimi: pasuria në vitin 2020 dhe blerjet e vitit 2021, përlogaritur edhe normën mesatare të zhvlerësimit 20%). • Spitali i Mitrovicës në pasqyrat individuale të vitit 2021 kishte shpalosur pasurinë jo kapitale nën 1000€ në vlerë 82,110€, duke i përfshirë vetëm blerjet e vitit dhe jo gjithë pasurinë që ka në</p>	<p>Rekomandimi B2 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se Se para përgaditjes së PVF-ve të konsoliduara të SHSKUK të kryhen kontrollime të mirefillta të informative të prezentuara nga ana e programeve dhe të njetat të pasqyrohen saktë dhe të sigurohet raporti i drejt I tyre.</p>	<p>B2 Do të ndërmerren veprime konkrete që gjatë përgatitjes së PFV informatat të paraqiten saktë dhe drejtë. Menaxhmenti i Spitaleve të Përgjithshme do të ndërmerr të gjitha hapat për të përmirësuar gjendjen.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i pasurisë</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Nga zyrtaret në programet e cekura është përcjellur me gabime teknike të cilat nuk do të përseriten</p>
---	--------------------------	--	--	--	---	------------------	--

		<p>pronësi/menaxhim. Këto parregullsi kanë ndodhur pasi që kontrollat e brendshme nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente gjatë vitit si dhe për shkak të mos kontrollit të duhur të shënimeve me rastin e konsolidimit të informatave nga ana e SHSKUK-së. Kjo e fundit, këto shifra të prezantuara nga programet në PFV-te individuale, i kishte marrë si të mirëqena, dhe të njëjtat, pa i verifikuar i kishte shpalosur edhe në PFV-të e SHSKUK-së.</p>					
4	Çështja B3	<p>Çështja B3 - Keqklasifikimi i shpenzimeve Gjetja Sipas nenit 18 pika 3 e Rregullës financiare nr. 01/2013 shpenzimet duhet të realizohen dhe të evidentohen në kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. SHSKUK kishte bërë pagesa nga kategoritë jo adekuate që kishin rezultuar me keq klasifikime prej 519,241€ si në vijim: • Shpenzime në vlerë 391,693€ (QKUK-257,937€, Spitali i Gjilanit 40,749€, Spitali i Vushtrisë – 33,864€, Spitali i Ferizajit – 14,449€,</p>	<p>Rekomandimi B3 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se me rastin e planifikimit të projekteve bëhet një analiz e mirëfilllet e natyres se shpenzimeve dhe ashtu që projektet të buxhetohen në përputhje me natyren e shpenzimit, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PVF sipas standardeve të kontabilitetit dhe në përputhje me planin kontabel</p>	<p>B3 Marrë parasysh situatën në të cilën ka operuar ShSKUK dhe gjendjes emergjente të pandemisë COVID-19 janë ndërmarrë veprime të domosdoshme për menaxhimin e pandemisë, e cila ka krijuar situatë të re me ç'rast planifikimet e rregullta jemi obliguar t'i përshtaten gjendjes së krijuar. Janë ndërmarrë veprime dhe janë udhëzuar të gjithë menaxherët e Spitaleve të Përgjithshme që raste të tilla të mos përsëriten.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i pasuris</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Pandemia COVID-19 ka krijuar një situatë të re ku planifikimet e rregullta jemi obliguar ti përshtemi situates se krijuar për ta menaxhuar pandemin Covid-19</p>

		<p>Spitali i Prizrenit - 13,604€, Spitali i Pejës - 12,450€, Spitali i Mitrovicës - 9,450€ dhe QSKUK - 9,190€) që për nga natyra i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale. Ato kishin të bënin me blerjen e bombolave të oksigjenit, furnizime me material mjekësor, pajisje mjekësore, instrumente mjekësore etj.; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pagesa përmes vendimeve gjyqësore për paga jubilarë në vlerë 125,978€, ishin ekzekutuar nga kategoria e komunalive (Spitali i Gjilanit - 27,064€) dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (Spitali i Prizrenit - 98,065€) deri sa do të duhej të ekzekutoheshin nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Keq klasifikimet kishin ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve në kategoritë përkatëse për të ju përshtatur nevojave që kanë dalur për menaxhimin e pandemisë. 					
5	Çështja A2	<p>Çështja A2 - Mangësi në vlerësimin e procedurave të prokurimit Gjetja Neni 59, paragrafi 4 i Ligjit të Prokurimit Publik me Nr. 04/L-042 thekson se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Më tutje, sipas RRUPP neni 27 pika 27, OE-të nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në</p>	<p>Rekomandimi A2 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm se bashku me drejtorin e përgjithshëm të Gjilanit duhet të sigurojnë se vlersimi I tendereve bëhet në pajtim të plot me kriteret përcaktuara në dosjen e tenderit, në mënyrë që të arrihen objektivat e parapara</p>	<p>A2 Për dosjen e tenderit nga Spitali i Gjilanit "Furnizim me Sterilizator Plazma me material përcjellës hargjues", dosja ishte e kompletuar dhe për këtë janë ofruar dëshmitë përkatëse. të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj letre konfirmimi</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i prokurimit</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Në rastin e par kompanija ka ofruar dokumentin e qarkullimit bankar për 3 vite në vlerën 7,486,646.37 po ashtu edhe qarkullimin për 3 vite nga ATK në vlerën mbi 11 milion, në rastin e dytë nga 9</p>

	<p>të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit.</p> <p>Në dy raste të vlerësimit të ofertave, AK kishte shpërblyer me kontratë OE të papërgjegjshëm, si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tek dosja e tenderit "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material përcjelljes harxhues" të Spitalit të Përgjithshëm Gjilan në vlerë 44,250€, në kuadër të kapacitetit ekonomik dhe financiar ishte kërkuar vërtetimi nga banka komerciale i qarkullimit financiar prej 120,000€ për tri vitet e fundit. OE fitues kishte ofruar një vërtetim që mbulonte shumën e kërkuar për qarkullim, por i cili nuk specifikonte periudhën e mbuluar, që ishte e specifikuar si kërkesë e Dosjes së tenderit; dhe • Në procedurën e prokurimit "Shërbime funerali Covid -19" në vlerë 158,000€, kemi vërejtur se dy nga nëntë kompanitë që kishin ofertuar (kompania "Funerali " dhe " Ngushëllimi"), janë palë të ndërlidhura. Bazuar në dokumentacionin e ofertuar, kemi parë që, pronari i kompanisë "Ngushëllimi" ka aksione edhe në kompaninë " Funerali" dhe po ashtu i njëjti mban pozitën e drejtorit menaxhues në të dyja kompanitë. Përkundër kësaj, SHSKUK ka shpërblyer me kontratë kompaninë "Funerali", e cila sipas kërkesave ligjore do të duhej të vlerësohej si e pa përgjegjshme. Kjo situatë ishte reflektuar nga pakujdesia e anëtarëve të komisionit të 					operator që kanë konkuruar është kualifikuar kompanija me e lirë
--	--	--	--	--	--	--

		vlerësimin dhe mbikëqyrjes së procesit të vlerësimin nga departamenti i prokurimit.					
6	Çështja A3	<p>Çështja A3 - Angazhimi i punonjësve shëndetësorë në spitalet rajonale pa procedura</p> <p>Gjetja Neni 84 i Ligjit nr.06/ L-111 për Zyrtarët Publikë, përcakton që, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik</p> <p>SHSKUK, përkatësisht spitalet rajonale gjatë vitit 2021, kishin angazhuar stafin shtesë shëndetësor prej 52 specialistëve, 30 specializantëve, si dhe dy teknikëve për mbajtjen e kujdestarive. Angazhimi i këtyre punonjësve ishte bërë në formë të ndryshme, varësisht nga spitalet regjionale, ku disa spitale kishin aplikuar kontrata pune për kohë të caktuar, marrëveshje bashkëpunimi, apo përmes vendimeve. Kjo ishte në kundërshtim me ligjin përkatës i cili specifikon që marrëveshjet për shërbimet e veçanta duhet të lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Vlera totale e pagesës për të angazhuarit gjatë vitit 2021 ishte 347,702€.</p> <p>Sipas zyrtarëve përgjegjës, kjo kishte ndodhur për shkak të deficitit të stafit mjekësor nëpër këto spitale dhe shtimit të pacientëve për shkak të pandemisë Covid 19.</p>	<p>Rekomandimi A3</p> <p>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se angazhimi i profesionistëve shëndetësor të bëhet pas vlerësimit zyrtar të nevojave të spitaleve si dhe në pajtim me kërkesat që dalin nga ligji për zyrtarët publik</p>	<p>A3 Procedura për këtë aktivitet është pezulluar nga KRPP përmes njoftimit publik me nr.69/2020 të datës 05/11/2020 (të bashkangjitur në këtë letër konfirmimi). Kjo situatë ka sjellë në vështirësi Spitalet e Përgjithshme në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për numrin e shtuar të pacientëve të sëmurë nga COVID-19.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i personelit dhe prokurimit</p>	I zbatua	<p>Komisjoni Rregullativ i Prokurimit Publik-KRPP ka pezulluar këtë aktivitet përmes njoftimit publik me numer protokoli 69/2020 të datës 05/11/2020</p>

7	Çështja A4	<p>Çështja A4 - Mungesë e raporteve të pranimit të mallrave nga menaxherët e kontratës</p> <p>Gjetja Neni 81 i Ligjit të Prokurimit Publik si dhe RRUPP në 61- Menaxhimi i</p> <p>Kontratës, parashihet përgjegjësitë e menaxherit të projektit, si: a) menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;</p> <p>(b) sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; c) të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës a me termat dhe kushtet e kontratës; d) të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit etj.</p> <p>Nga testimi i pagesave, kemi vërejtur se në 61 raste në vlerë 7,864,454€, edhe pse kishte raport të pranimit nga komisioni i pranimit të mallit, mungonte raporti i pranimit të mallit i</p>	<p>Rekomandimi A4</p> <p>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë përpilimin e planeve të menaxhimit të kontratës nga ana e menaxhereve në mënyrë që të sigurohet përmbushja e kontratave sipas kritereve të parapara. Me tutje, para ekzekutimit të pagesave, të sigurohet se është marrë tërsi shërbimi përkates</p>	<p>A4 Janë ndërmarrë veprime që të gjitha kërkesat ligjore të përmbushen në tërësi nga menaxherët e kontratave.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i prokurimit</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Menaxhimi i stokut farmaceutik bëhet përmes sistemit SMSF</p>
---	-------------------	--	---	---	---	------------------	--

		<p>përgatitur nga menaxherët e kontratave.</p> <p>Sipas SHSKUK, shkak i mungesës së raportit të pranimit të mallit nga menaxherët e kontratave është ngarkesa e madhe e punës së menaxhereve përkatës.</p>					
8	Çështja A5	<p>Çështja A5 - Vonesa në pagesën e faturave</p> <p>Gjetja Sipas nenit 17.1 të Rregullores 01/2017 për PFV të OB, ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë, për mallrat dhe shërbimet e furnizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore. Në 12 raste me vlerë 2,448,184€, kemi vërejtur se faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga tetë ditë deri në gjashtë muaj.</p> <p>Sipas zyrtarëve përkatës, vonesat për ti kryer pagesat me kohë kishte ndodhur për shkak të mungesës së buxhetit si rezultat i nevojave të shtuara nga pandemia,</p>	<p>Rekomandimi A5</p> <p>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të gjithë faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh dhe porosija e mallrave apo shërbimeve bëhet vetëm atëher kur paraprakisht janë siguruar fondet apo ndarjet mjetet buxhetore të mjaftueshme për pages</p>	<p>A5 Vonesat janë paraqitur si pasojë e mungesës së mjeteve buxhetore për menaxhimin e pandemisë COVID-19. Për këtë qëllim, SHSKUK në vazhdimësi ka parashtruar kërkesat për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projekteve emergjente për menaxhimin e pandemisë COVID-19.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF</p>	<p>I Zbatuar</p>	<p>Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia në nivelin global edhe në vendin tonë janë rritur kërkesat edhe cmimet dhe në mungesë të buxhetit janë vonuar pagesat në disa raste</p>

9	Çështja A6	<p>Çështja A6 - Vazhdim i kontratës së punës në mungesë të konkursit publik Gjetja Neni 64. paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, përcakton që SHSKUK udhëhiqet nga Bordi Drejtues. Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni, përcakton që Bordi Drejtues përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, nga të cilët një ekspertë i menaxhmentit shëndetësor me kualifikime të larta profesionale dhe shkencore i zgjedhur në bazë të konkursit publik'. Më tutje, paragrafi 6 përcakton që mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues zgjatë tri (3) vite. SHSKUK gjatë vitit 2018 kishte lidhur kontratë punë tri vjeçare me anëtarin e shtatë të Bordit Drejtues - Drejtorin Financiar / Ekspertin e Ekonomisë dhe menaxhmentit shëndetësor për një periudhë tre vjeçare, me mundësi vazhdimi. Pas skadimit të kontratës së punës në korrik 2021, Bordi iri Drejtues i kishte vazhduar kontratën e punës të njëjtit edhe për tri vite të tjera bazuar në vlerësimin e performancës. Kjo në kundërshtim me Ligjin për Shëndetësi, i cili specifikon se mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues zgjatë tri vite dhe i njëjti duhet të zgjidhet në bazë të konkursit publik. Kjo kishte ndodhur për shkak se Bordi Drejtues kishte vlerësuar se të njëjtit mund t'i vazhdohet kontrata e punës.</p>	<p>Rekomandimi A6 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurohen se me rastin e lidhjes së kontratës së punës për antarin e shtatë të BD të bëhet respektimi i plot i kërkesave të ligjit për shëndetsi</p>	<p>A6 Bordi Drejtues në të ardhmen do të ndërmerr hapat e nevojshëm për harmonizimin e kontratës në përputhje me kërkesat ligjore.</p>	BD	I zbatuar	Konkursi ka qenë në përputhje me statutin dhe rregulloren e punës, po ashtu edhe konkursi edhe kontrata ka qenë me mundësi vazhdimi
---	-------------------	---	---	---	----	-----------	---

10	<p>Çështja A7</p>	<p>Çështja A7 - Gabime në prezantimin e informatave në PFV Gjetja Sipas nenit 13, pika 3 e Rregullores MF – Nr.01/ 2017 për raportim vjetor financiar të organizatave buxhetore, shuma që paraqitet si burim i fondeve është shuma aktuale e shpenzimeve të bëra përmes LLVTH-së dhe paraqet burimin e fondeve të shpenzuara. Më tutje, neni 16, për të arkëtueshmet, përcakton që “Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Poashtu neni 18, specifikon se organizatat buxhetore në harmoni LMFPF-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente. Në Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 për SHSKUK, kemi identifikuar keq deklarimet në vijim; Tek neni 13, pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, ishte mbivlerësuar shuma e pranimeve nga granti qeveritar për 5,248€, duke e mbivlerësuar edhe totalin e pranimeve për të njëjtën shumë; Salldo e llogarive të arkëtueshme të prezantuara në PFV nuk ishte e saktë, për shkak se, SHSKUK me rastin e konsolidimit të PFV-ve me programet e saj, nuk kishte përfshirë llogari të arkëtueshme në vlerë 4,524€, të prezantuara nga Spitali i Gjilanit në PFV-të e tij. Poashtu, llogari të arkëtueshme të QKUK-së në vlerë 16,988€, të cilat ishin inkasuar në</p>	<p>Rekomandimi A7 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle me të forta në përgaditjen dhe konsolidimin e të dhenave në PVF në menyr që ato të prezantoj gjendjen e saktet te të gjitha zerave</p>	<p>A7 Puna nën presion gjatë pandemisë COVID-19 ka reflektuar aktivitetet e zyrtarëve përkatës. Pika 1 e kësaj gjetje është përmirësuar brenda afateve dhe në vijim do të ndërmerren masat e nevojshme për rritjen e kontrollit gjatë përgatitjes së PFV.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Në baz të ligjit të financave publike lejohet përmirsimi i PVF deri 31.03, pas përmirimit në sistem nga thesari kemi vepruar brenda këtij afati kohor nuk në nenin 13 dhe 14 të PVF është përmirësuar kjo diferenc</p>
----	--------------------------	---	--	---	-----------------------------------	------------------	---

		<p>vitin2022, nuk ishin përfshirë në salldon e përgjithshme të prezantuar në PVF-të e vitit 2021.</p> <p>Salldo e detyrimeve kontigjente të prezantuara në PFV nuk ishte e saktë, pasi që SHSKUK kishte përfshirë detyrime në vlerë 40,492€ që i takonin Spitalit të Gjilanit, të cilat tashmë ishin paguar, duke e mbivlerësuar këtë llogari;</p> <p>Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së kujdesit të duhur me rastin e përgatitjes dhe konsolidimit të informatave në PFV-ve nga ana e SHSKUKsë.</p>					
11	Çështja A8	<p>Çështja A8 - Ushtrimi i pozitës drejtuese me punë sekondare</p> <p>Gjetja Statuti i QKUK, Neni 16 Zgjedhjet në pozita udhëheqëse, paragrafi 4 përcakton që "Drejtorët e klinikave dhe shërbimeve klinike duhet të jenë me orar të plotë".</p> <p>QKUK me rastin e përzgjedhjes së Drejtoreshës së Pediatriisë kishte nënshkruar kontratë të punës me orar të plotë, përderisa në listën e pagave e njëjta paguhet si e punësuar me gjysëm orari (20 orë pune), kjo në kundërshtim me kriterin përkatës në Statut i cili përcakton se Drejtorët e klinikave dhe shërbimeve klinike duhet të jenë me orar të plotë.</p> <p>Sipas QKUK kjo kishte ndodhur si pasojë e angazhimit të drejtoreshës edhe në procesin arsimor ku punën në universitet e kishte deklaruar si punë primare ndërsa punën në QKUK kishte deklaruar si pagë sekondare.</p>	<p>Rekomandimi A8</p> <p>Bordi Drejtues dhe Drejtori I Përgjithshëm të siguroj se kontratat e punës zbatohen në pajtim të plot me Statutin e QKUK-së</p>	<p>A8 Profesionistët shëndetësorë që janë profesorë /ose asistentë në Fakultetin e Mjekësisë përcaktohen për pagë primare në Fakultetin e Mjekësisë, ndërkohë që orarin e plotë të punës e zbatojnë në QKUK.</p>	BD, DP	I zbatuar	Ligji ju mundeson profesionistëve shëndetësor të zgjedhin pagën primare, ndërsa drejtori në fjalë kryen detyrën me orar të plot në QKUK

12	Çështja A9	<p>Çështja A9 - Mungesë e dëshmime për vijueshmërinë e orarit të punës Gjetja Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr 12/ 2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publikë, specifikon se gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik. Mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore. Nga testimi i vijueshmërisë së stafit, kemi vërejtur se në 15 raste nuk ka dëshmi për vijueshmëri të orarit të punës. Kjo për shkak që mungon një mekanizëm funksional i monitorimit të regjistrimit të plotë të hyrje daljeve të stafit gjatë orarit të punës, përkundër faktit që sistemi elektronik i regjistrimit të vijueshmërisë është funksional. Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së monitorimit të mirëfilltë të stafit nga ana e menaxherëve drejtues për respektimin e orarit të punës.</p>	<p>Rekomandimi A9 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të siguroj respektimin e orarit të punës nga ana e stafit në pajtim me rregullat përkatëse. Në rast të shkeljeve të evidentuara nga komisioni përkatës, të ndermerren masat disiplinore adekuate</p>	<p>A9 Marrë parasysh situatën me pandeminë COVID-19 në kohën e valëve epidemike janë shmangur kontaktet e ngushta për shkak të mundësisë së përhapjes së infeksionit. Megjithatë, për këtë çështje janë ndërmarrë veprime përmirësuese për të siguruar monitorimin e respektimit të orarit të punës.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP, zyrtari i personelit</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Për shkak të situatës pandemike janë shmangur kontaktet e ngushta për shkak të përhapjes së infeksionit</p>
13	Çështja A10	<p>Çështja A10 - Caktimi i të punësuarit në vendin e punës në kundërshtim me përgatitjen profesionale specialiste Gjetja Ligji i punës nr 03/ L-212, neni 17 - caktimi i të punësuarit në vendin e punës paragrafi 1, specifikon se, 1. I punësuar caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur kontratë pune. 2. Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuarit në pajtim me kontratën e punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të</p>	<p>Rekomandimi A10 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj sisteminin e punonjës në vendin e punës perkritazi me përgatitjen e saj profesionale</p>	<p>A10 Punonjësja është punësuar me aktvendim të Gjykatës së Apelit me nr.4080 të datës 16.08.'19. (vendimi i bashkangjitur në këtë letër konfirmim). Do të bëhen përpjekje që sigurojnë sisteminin e punonjës sipas përgatitjes profesionale.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP, zyrtari i personelit</p>	<p>Tetor 2022</p>	<p>Rasti ka qenë në gjykatë dhe me vendim gjygesor është obliguar institucioni ta kthejë në punë</p>

		<p>njëjtë të pagës, në pajtim me kontratën e punës.</p> <p>SHSKUK gjatë vitit 2018 kishte lidhur kontratë pune tre vjeçare me specialisten e diplomuar në lëmin Pedodonci dhe Stomatologji preventive të cilës i ishte caktuar vendi i punës në Spitalin e Mitrovicës, përkundër faktit që ky spital nuk posedon Repart të Stomatologjisë. Si rezultat i mungesës së kushteve elementare të punës për ushtrimin e profesionit të saj, zyrtarja në fjalë nuk mund të kryej shërbimin për të cilën paguhet. Vlera e pagave të paguara për zyrtaren përkatëse për vitin 2021 ishte në vlerë 9,846€.</p> <p>Sipas SHSKUK, kjo kishte ndodhur për shkak se menaxhmenti i atëhershëm kishte rekomanduar këtë kandidatë për specializim në stomatologji duke e ditur që shërbimi specialistik nuk ofrohet në kuadër të spitalit.</p>					
15	Çështja A11	<p>Çështja A11 - Mangësi në procedimin e pagesave</p> <p>Gjetja Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, neni 22, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.</p> <p>Në 17 raste në vlerë 1,759,514€, urdhër blerjet ishin proceduar pas pranimit të mallit dhe faturës. Këto raste kishin ndodhur tek pagesat për: sigurimin e automjeteve, karburante për vetura, furnizim me ushqim,</p>	<p>Rekomandimi A11</p> <p>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollin e brendshme, edhe nga zyrtaret përgjegjës të kerkoj zbatimin e procedurave duke filluar me iniciimi I shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave</p>	<p>A11 ShSKUK është përballur me kërkesa të shtuara dhe presione të vazhdueshme për sigurim të furnizimit të qëndrueshëm dhe me kohë për menaxhimin e pandemisë COVID-19. Për këtë do të bëhen përpjekje për shtimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e procesit të pagesave.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i prokurimit</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Automjetet furnizohen përmes kontrates se AQP-së dhe në fund të muajit vjen fatura për pages</p>

		furnizim me pastrim, furnizime mjekësore, sigurim fizik të objekteve etj. Shkaku i dobësive në procedimin e pagesave ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në procesin e realizimit të blerjeve.				
Çështja A12	<p>Çështja A12 - Mos respektimi i afateve kohore në procedurën e prokurimit</p> <p>Gjetja Sipas RrUOPP , nenit 22.3, pika f. Njoftim për nënshkrim të kontratës, specifikon se "nëse një AK ka nënshkruar një kontrate publike duke përdorur procedurën e hapur, kufizuar, konkurruese me negociata, negociuar pa publikim, kuotim të çmimit ose me vlere minimale, brenda dy ditë, pas nënshkrimit, ZP do të përgatis Njoftimin për nënshkrim te kontratës pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar.</p> <p>Në një rast, tek SP Mitrovicë në procedurën e prokurimit "Plumbimi, renovimi, lysterja dhe funksionalizimi i kthinave spitalore" në vlerë 43 205€, njoftimi për nënshkrimin e kontratës ishte bërë tre muaj pas nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Sipas menaxherit të prokurimit vonesat kishin ndodhur për shkak të defekteve në sistemin e e-prokurim-it.</p>	<p>Rekomandimi A12</p> <p>Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë respektimin e afateve kohore ligjore me rastin e pergaditjes se njoftimit për nënshkrim të kontrates</p>	<p>A12 Menaxhmenti i Spitalit të Mitrovicës ka konfirmuar se gjetja qëndron, dhe kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të sistemit elektronik në momente të caktuara.</p>	BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i prokurimit	I zbatuar	Ditet që ka qenë afati i njoftimit nuk ka funksionuar sistemi elektronik

<p>Çështja A13</p>	<p>Çështja A13 - Menaxhimi i kontratës me vlerë të madhe, vetëm nga një menaxher projekti Gjetja Neni 61.17 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP) parashih qe një kontratë me vlerë të madhe dhe qe është komplekse ose është pjesë e një projekti me të madh, ti jepet një ekipi për menaxhim të Projekti i cili ka përgjegjësitë e njëjta si Menaxheri i Projektit. Nga testimi i shtatë pagesave në vlerë 656,980€ që kishin të bënin me kontratën për projektin "Ndërtimi i Objektivit Spitalor për Nëna dhe Fëmijë në Prizren" kemi vërejtur se menaxhimi i projektit ishte bërë vetëm nga një menaxher projekti edhe pse vlera e kontratës ishte 4,915,029€ dhe hyn në grupin e kontratave të mëdha. Sipas prokurimit, SHSKUK kishte hapur tender për mbikëqyrjen e këtij projekti nga një kompani profesionale, mirëpo pas ankesave lënda ka përfunduar në OSHP me ç'rast në mungesë të Bordit të këtij organi ka mbetur pa u trajtuar.</p>	<p>Rekomandimi A13 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurohen që në rastet e kontratave me vlera të medha dhe punë komplekse të angazhohet ekip për menaxhim të kontratave sipas kërkesës se legjislacionit në fuqi</p>	<p>A13 ShSKUK ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për kontraktimin e një kompanie për menaxhimin e kontratës duke aplikuar procedurat përkatëse të prokurimit. Gjatë zhvillimit të procedurës janë parashtruar ankesa të cilat ende janë në trajtim në OSHP, organ i cili aktualisht është jofunksional.</p>	<p>BD, DP, Drejtoret e SP,ZKF, zyrtari i prokurimit</p>	<p>Pjeserish I zbatuar deri ne pergjigjeje në OSHP</p>	<p>ShSKUK ka vepruar sipas ligjit ku ka shpallur procedurat, pas ankesave lënda është dërguar në OSHP</p>
<p>Çështja A14</p>	<p>Çështja A14 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit gjatë gjithë vitit Gjetja Sipas nenit 4 të UA MF-NR 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit. Më tutje, neni 8, specifikon se takimet e Komitetit të Auditimit,</p>	<p>Rekomandimi A14 Bordi Drejtues duhet të siguroj se roli dhe misioni I KA në SHSKUK po përmbushet dhe funksioni I auditimit te brendeshem është I monitoruar mire me qellim që të arrihet objektivat e synuara të organizates.</p>	<p>A14 Në muajin korrik ka përfunduar mandati i Komitetit të Auditimit, ndërsa Komiteti i ri është formuar në muajin dhjetor po të njëjtit vit</p>	<p>BD</p>	<p>I zbatuar</p>	<p>Në muajin korrik ka përfunduar mandati i komitetit, ndersa komiteti i ri është formuar në muajin dhjetor për shkak të procedurave</p>

		<p>mbahen së paku katër herë në vit, derisa neni 10 përcakton që Komiteti i Auditimit përgatitë raport vjetor për udhëheqësin e subjektit publik të sektorit publik.</p> <p>Mandati i Komitetit të Auditimit në SHSKUK kishte përfunduar në muajin korrik të vitit 2021 dhe brenda kësaj periudhe, i njëjti kishte mbajtur vetëm një takim. SHSKUK edhe pse kishte mbetur pa Komitet të Auditimit nuk kishte themeluar Komitetin e ri të Auditimit deri me 15 dhjetor 2021. Komiteti i ri i Auditimit për shkak të kohës së shkurtër, pas marrjes së mandatit, nuk kishte përgatitur as Raportin Vjetor për vitin 2021, siç kërkohet me rregullën përkatëse. Kjo kishte ndodhur si pasojë e vonesës në emërimin e Komitetit të ri të auditimit nga ana e Bordit Drejtues.</p>					